

**VENDIM**  
**Nr. 493, datë 21.7.2022**

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E  
RINDËRTIMIT TË OBJEKTEVE ARSIMORE NË BASHKINË KAVAJË DHE  
CAKTIMIN E BASHKISË KAVAJË SI NJËSI ZBATUESE**

*(Ndryshuar me VKM nr. 828, datë 26.12.2024)*

*(I përditësuar)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” e “iii”, 16, dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rindërtimit të 2 (dy) objekteve arsimore në Bashkinë Kavajë, në masën 325 000 000 (treqind e njëzet e pesë milionë) lekë pa TVSH, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Rindërtimi i kopsht/çerdhe në fshatin Luz i Vogël, Bashkia Kavajë, në masën 110 000 000 (njëqind e dhjetë milionë) lekë pa TVSH;

b) Rindërtimi i kopsht/çerdhe në fshatin Golem, Bashkia Kavajë, në masën 215 000 000 (dyqind e pesëmbëdhjetë milionë) lekë pa TVSH.

2. Bashkisë Kavajë, në buxhetin e vitit 2022, i transferohet fondi në masën 65 000 000 (gjashtëdhjetë e pesë milionë) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, i cili përballohet nga hapësira buxhetore e siguruar pas ngurtësimit në të njëjtën masë të fondeve të projekteve të rindërtimit me ecuri të ngadaltë.

*2/1. Bashkisë Kavajë, në buxhetin e vitit 2024, i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar, në masën 98 003 159,35 (nëntëdhjetë e tetë milionë e tre mijë e njëqind e pesëdhjetë e nëntë presje tridhjetë e pesë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të 2 (dy) objekteve arsimore në Bashkinë Kavajë, i cili do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2024, sipas detajimit të mëposhtëm:*

*a) Rindërtimi i kopsht/çerdhe në fshatin Luz i Vogël, Bashkia Kavajë, në masën 53 000 000 (pesëdhjetë e tre milionë) lekë pa TVSH;*

*b) Rindërtimi i kopsht/çerdhe në fshatin Golem, Bashkia Kavajë, në masën 45 003 159, 35 (dyzet e pesë milionë e tre mijë e njëqind e pesëdhjetë e nëntë presje tridhjetë e pesë) lekë pa TVSH.*

3. Caktimin e Bashkisë Kavajë si njësi zbatuese për financimin e rindërtimit të objekteve arsimore, sipas pikave 1, 2 dhe 2/1, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kavajë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**